

**URDHËR**  
**Nr. 717, datë 24.7.2025**

**PËR SHFUQIZIMIN E URDHRAVE “PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ  
SËMUNDJES SË PSEUDOPESTIT TË SHPENDËVE”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 3, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

**URDHËROJ:**

1. Shfuqizimin e:

- urdhrit nr. 1099, datë 19.12.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit, të shfaqur në shtetin e Italisë”;

- urdhrit nr. 506, datë 23.5.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit, të shfaqur në shtetin e Maltës”.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**  
**Anila Denaj**